

VENDIM
Nr.548, datë 12.8.2004

**PËR NJË NDRYSHIM LIMITI NË FONDET E KUSHTËZUARA, MIRATUAR NË
BUXHETIN E VITIT 2004, PËR MINISTRINË E KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
DHE MINISTRINË E MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 29 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe e nenit 14 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2004, t’i shtohet fondi i kushtëzuar me shumën 7 000 000 (shtatë milionë) lekë, në zërat si më poshtë vijon:
 - Zëri “Shpenzime operative” 4 500 000 (katër milionë e pesëqind mijë) lekë;
 - Zëri “Paga e shpërblime të tjera” 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë.
 2. Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e miratuar për vitin 2004, t’i pakësohet fondi i kushtëzuar me shumën 7 000 000 (shtatë milionë) lekë, zëri “Paga e shpërblime të tjera”.
 3. Ngarkohen Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano